

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6683  
E premte, 19 gusht 2022  
çmimi 0.40 €

Ish-diplomati britanik:  
Gjithçka të çon në  
bashkimin e Kosovës me  
Shqipërinë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI KURTI DHE PRESIDENTI VUÇIQ ZHVILLUAN  
DY RAUNDE BISEDIMESH NË BRUKSEL | FAQE 4-5

## S'KA MARRËVESHJE NË BRUKSEL

*- Borrelli: Nuk arritëm marrëveshje,  
por negociatat do të vazhdojnë*



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të enjten në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, ka bërë me dije se nuk është arritur ndonjë marrëveshje për targarat dhe dokumentet serbe, por ka thënë se negociatat do të vazhdojnë.

Borrelli ka thënë se takimi Kurti - Vuçiq ka qenë i fokusuar në uljen e tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Dy liderët (Kurti dhe Vuçiqi) u pajtuan se procesi duhet të vazhdojë dhe diskutimi do të rikthehet në ditët e ardhshme dhe ka kohë deri më 1 shtator", ka thënë Borrelli

**NAGAVCI: TË GJITHË  
PUNËTORËT E ARSIMIT  
JANË TRAJTUAR ME  
KUJDES TË VEÇANTË  
NË PROJEKTLIGJIN  
PËR PAGA** | FAQE 7



**TAHIRI: PROJEKTLIGJI PËR ZYRTARËT  
PUBLIKË S'DUHET TË KALOJË** | FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### SPORT



**"ALBI MALL", SPONSOR  
GJENERAL I SUPERLIGËS SË  
KOSOVËS NË FUTBOLL** | F. 8

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Abazoviqi sot para votës së mosbesimit në Kuvend

PODGORICË, 18 GUSHT - Qeveria e Malit të Zi, e drejtuar nga shqiptari Dritan Abazoviq, sot (e premte) do të përballet me votën e mosbesimit.

Nisma për thirrjen e mocionit është e Partisë Demokratike Socialiste të presidentit Millo Gjukanoviç dhe është mbështetur nga pesë parti.

Janë 36 nënshkrime të mbledhura deri më tani nga deputetët për thirrjen e kësaj seance, derisa duhen edhe pesë të tjera. Abazoviqi është zgjedhur

kryeministër i Malit të Zi më 28 prill, ndërsa mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë që drejton ai është thirrur pas marrëveshjes me Kishën Ortodokse Serbe.



## Rusia, Ukrainës: Nëse vazhdoni sulmet, do ta mbyllim centralin bërthamor Zaporizhzhia



MOSKË, 18 GUSHT - Rusia ka paralajmëruar se mund ta mbyllë centralin bërthamor të Zaporizhzhias nëse Ukraina

vazhdon ta bombardojë objektin, një pretendim që Kievi e ka mohuar, shkruan "The Guardian". Kreu i forcave të mbrojtjes

radioaktive, kimike dhe biologjike të Rusisë ka thënë se sistemet mbështetëse të ndërtesës ishin dëmtuar nga sulmet. Në një rast

incidenti, ka thënë Igor Kirillov, materiali radioaktiv do ta mbulonte Poloninë, Gjermaninë dhe Slloveninë. Si Rusia ashtu edhe

Ukraina e kanë akuzuar njëra-tjetrën për sulmet ndaj centralit dhe të dyja kanë hedhur poshtë akuzat e njëra-tjetrës.

## Turqia dhe Izraeli do t'i rivendosin raportet e plota diplomatike

JERUSALEM, 18 GUSHT - Izraeli dhe Turqia do t'i rivendosin raportet e plota diplomatike dhe do t'i dërgojnë ambasadorët e tyre në shtetet përkatëse për herë të parë pas shumë vitesh, ka deklaruar kryeministri në detyrë i Izraelit, Yaïr Lapid. "Rivendosja e raportet me Turqinë është një aset i rëndësishëm për stabilitetin rajonal dhe një lajm shumë i rëndësishëm ekonomik për qytetarët e Izraelit", ka thënë ai

përmes një deklaratë zyrtare. Ky vendim vjen pasi Lapid ka vizituar Ankarën në qershor, ku ka zhvilluar bisedime me presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Dikur aleatë të ngushtë, Turqia dhe Izraeli kanë përkeqësuar raportet në vitin 2010 pasi dhjetë shtetas së Turqisë janë vrarë kur marina izraelite pati sulmuar një anije që po dërgonte ndihma në Gaza.



Dy shtetet kanë pasur një përmirësim të raporteve më 2016, por që nga viti 2018, kur pati mosmarrëveshje për hapjen e Ambasadës Amerikane në

Jerusalem, të dy shtetet nuk kanë pasur ambasador në kryeqytetet e njëri-tjetrit. Turqia nuk e njeht Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit dhe ambasada e saj gjendet në Tel Aviv. "Edhe ne kemi vendosur që ta emërojmë ambasadorin tonë në Izrael, Tel Aviv", ka thënë ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, gjatë një prononcimi për gazetarë në Ankara. Ai ka thënë se ky vendim është "një hap pozitiv".

Por, Cavusoglu ka thënë se Turqia do të vazhdojë ta mbrojë kauzën palestineze. "Siç e kemi thënë gjithmonë, ne do të vazhdojmë t'i mbrojmë të drejtat e palestinezëve", ka thënë ai. Palestinezët duan që shteti i tyre i ardhshëm të krijohet në territoret që Izraeli i ka marrë në luftën e Lindjes së Mesme më 1967. Bisedimet për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palëstinez kanë ngecur që nga viti 2014.

## Estonia hoqi monumentin e epokës sovjetike, Rusia hakmerret me sulm kibernetik

Talin, 18 gusht - Estonia është goditur nga sulme të shumta kibernetike pas heqjes së një monumenti tankesh të epokës sovjetike nga një rajon, popullsia e të cilit është kryesisht rusë etnikë, ka thënë qeveria e saj. Grupi rus i hakerëve "Killnet" ka marrë përgjegjësinë për

sulmin, duke thënë se ka bllokuar qasjen në më shumë se 200 institucione shtetërore dhe private të Estonisë. Qeveria estoneze këmbënguli se ndikimi i sulmit ishte i kufizuar dhe kaloi "kryesisht pa u vënë re". "Dje Estonia iu nënshtrua sulmeve më të gjera kibernetike me të cilat është

përballur që nga viti 2007. Me disa përjashtime të shkurtra dhe të vogla, faqet e internetit mbetën plotësisht të disponueshme gjatë gjithë ditës. Sulmi ka kaluar kryesisht pa u vënë re në Estoni", ka thënë sekretari i Ministrisë së Estonisë i Çështjeve Ekonomike.



## Hovenieri thotë se respektimi i trashëgimisë fetare është ideal për çdo demokraci

GRAÇANICË, 18 GUSHT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA), Jeffrey Hovenier, së bashku me peshkopin Teodosje nga Rashka-Prizreni, kanë vizituar manastirin e Graçanicës. Hovenieri ka shkruar në

llogarinë e vet në "Twitter" se me peshkopin Teodosje ka biseduar për respektimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore. "Është kënaqësi ta shoh përsëri peshkopin Teodosje dhe të vizitoj manastirin e Graçanicës. Ne vazhduam diskutimin tonë

për faktin se çdo qytetar i Kosovës mund ta gëzojë lirinë pa diskriminim. Respektimi për trashëgiminë e larmishme fetare dhe kulturore është një ideal në çdo demokraci multietnike", ka shkruar ambasadori amerikan.



## Prokuroria në Prizren ngre aktakuzë ndaj tre personave, shmangën pagesat doganore



PRIZREN, 18 GUSHT (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren ka ngritur aktakuzë kundër tre personave, pasi dyshohet se kanë kryer veprën penale "Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore". Sipas aktakuzës, prej datës së pavërtetuar deri më 2 shkurt 2022 në Prizren, të pandehurit S. E., Y. E. dhe R. E., duke vepruar në bashkëveprim, në lokalet e tyre N. T. "E.T.", D.P.T. "S.T." dhe "G.S.", me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete, i janë shmangur pagesës së tarifave doganore. "Ata kryejnë bartjen e mallrave të ndryshme si: telefona mobilë të

markave të ndryshme, 'USB', 'Sony Playstation', 'Hard Disk', kamera sigurie, orë dhe pjesë të telefonave, të cilat mallra i kanë futur në mënyrë ilegale në Republikën e Kosovës, duke iu shmangur deklarimit në Doganën e Kosovës, e të cilat mallra më pas i fshehin në lokacione të ndryshme. Pastaj këto mallra ua shesin tregtarëve të ndryshëm në qytete të ndryshme të Kosovës, duke përfituar shuma të konsiderueshme materiale në vlerë të parave, me të cilat veprime kanë bërë shmangie nga pagesat e detyrueshme doganore dhe e kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë prej 17 028 50

eurosh" ka njoftuar Prokuroria në Prizren.

Me këtë rast, nga tre të akuzuarit janë sekuestruar dyzet e dy telefona mobilë të markave të ndryshme si: "iPhone", "Samsung Galaxy", "Nokia", etj., si dhe një numër i konsiderueshëm i pajisjeve të tjera të teknologjisë si: "USB", "Sony Playstation", "Hard Disk", kamera sigurie, orë etj. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit, si dhe sendet e sekuestruara të konfiskohen.

## Ish-diplomati britanik: Gjithçka të çon në bashkimin e Kosovës me Shqipërinë

PRISHTINË, 18 GUSHT - Timothy Less, ish-diplomat britanik në Bosnjë-Hercegovinë, ka deklaruar se "shqiptarët (në Kosovë) janë të shqetësuar për sigurinë e territorit të tyre dhe nuk duan t'ua japin një zonë autonome serbëve kur nuk janë të sigurt se do të në gjendje ta mbajë pjesën tjetër". "Në mungesë të ndonjë shansi njohjeje nga Serbia, e vetmja mundësi reale për Kosovën për t'i dhënë fund gjendjes së saj të paqartë është

bashkimi me Shqipërinë. Këtë e duan edhe shumica e shqiptarëve të Kosovës, pasi Kosova është një krijesë artificiale, një vend që i mungon kombi", thënë Less. Siç ka vlerësuar udhëheqësi i projektit "Studimet e shpërbërjes" të Qendrës për Gjeopolitikë dhe Strategji në Universitetin e Cambridgeit, në terma afatgjatë, një Shqipëri e madhe është "pothuajse e pashmangshme". Ai ka deklaruar se nuk sheh ndonjë perspektivë të

menjëhershme që Kosova apo Shqipëria ta shtyjnë këtë qëllim përtej nivelit të retorikës "për shkak të vetos ndërkombëtare dhe gjesteve të herëpashershme simbolike". "Në realitet, supozoj se ata do të presin, ashtu siç presin të tjerët në rajon, një ndryshim të rrethanave gjeopolitike dhe ardhjen e një kohe kur fuqitë e mëdha do të bien dakord për një riorganizim të gjerë të Ballkanit", ka thënë Less.



## Ministri Mehaj dhe gjenerali amerikan bisedojnë për sigurinë në Kosovë



PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka prituri në takim komandantin e Gardës Kombëtare të Iowa-s nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), gjeneralmajor Ben Corell. Në takim është diskutuar rreth situatës së sigurisë, lidhur me zhvillimet brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe me punën që është

duke u bërë për ta arritur përmbushjen e objektivave strategjike, të cilat janë në funksion të plotë të zhvillimit dhe forcimit të ushtrisë sonë. Gjithashtu, në këtë takim është theksuar se bashkëpunimi i kultivuar me Gardën Kombëtare të Iowa-s është ndërtuar falë angazhimit, përkushtimit dhe besimit të

dyanshëm. Ky bashkëpunim është vlerësuar lart edhe nga gjenerali Corell, i cili ka shprehur bindjen se ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tutje. Në fund të këtij takimi, ministri Mehaj ka falënderuar gjeneral Corell për bashkëpunimin dhe mbështetjen e ofruar nga Garda Kombëtare e Iowa-s për më shumë se një dekadë.

## Bie niveli i ujit në liqenin e Badocit dhe Batllavës

Prishtinë, 18 gusht (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" ka bërë thirrje për shpenzim racional të ujit të pijshëm. Në njoftim e kësaj kompanie është thënë se ka rënë niveli i

ujit në liqenin e Badocit dhe në atë të Batllavës. Sipas njoftimit, niveli i ujit në liqenin e Badocit është thënë se ka rënë në - 9 metra nën kuotën maksimale të kapërderdhjes. Ndërsa në

liqenin e Batllavës niveli i ujit ka rënë në -2.77 metra nën kuotën maksimale të kapërderdhjes. "Shpenzoni racionalisht ujin e pijshëm!", është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina".





KRYEMINISTRI KURTI DHE PRESIDENTI VUÇIQ ZHVILLUAN DY RAUNDE BISEDIMESH NË BRUKSEL

# S'ka marrëveshje në Bruksel

- Borrelli: Nuk arritëm marrëveshje, por negociatat do të vazhdojnë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të enjten në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, ka bërë me dije se nuk është arritur ndonjë marrëveshje për targat dhe dokumentet serbe, por ka thënë se negociatat do të vazhdojnë. Borrelli ka thënë se takimi Kurti - Vuçiq ka qenë i fokusuar në uljen e tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Dy liderët (Kurti dhe Vuçiqi) u pajtuan se procesi duhet të vazhdojë dhe diskutimi do të rikthehet në ditët e ardhshme dhe ka kohë deri më 1 shtator”, ka thënë Borrelli

targave dhe dokumenteve. Komuniteti ndërkombëtar s'do të shohë eskalim të situatës dhe palët do të jenë përgjegjëse për të. Ne nuk arritëm marrëveshje sot, por s'është fundi i tregimit. Dy liderët (Kurti dhe Vuçiqi) u pajtuan se procesi duhet të vazhdojë dhe diskutimi do të

rikthehet në ditët e ardhshme dhe ka kohë deri më 1 shtator”, ka thënë Borrelli në një konferencë për medie, duke shtuar se të dyja palët do të jenë fajtoreshë nëse esharon situata. “Të dyja palët do të jenë përgjegjëse për ndonjë eskalim të mundshëm”, është shprehur

Borrelli.

Para konferencës për medie, Borrelli ka thënë se është koha që Kosova dhe Serbia të lëvizin drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve teksa pritej të takoheshin në Bruksel. “Tensionet e fundit në veri të Kosovës kanë dëshmuar sërish se është koha të lëvizim drejt normalizimit të plotë. Pres që të dy liderët të jenë fleksibilë dhe të gjejnë gjuhë të përbashkët”, ka shkruar Borrelli në llogarinë e vet në “Twitter”.

As Kurti dhe as Vuçiq ende nuk kanë folur për medie pas takimeve në Bruksel.

Vuçiqi është larguar nga ndërtesa e BE-së, ndërsa shefi i së ashtuquajturës Zyrë e Qeverisë së Serbisë për Kosovën, Petar Petković, u ka thënë gazetarëve se Vuçiqi do të qëndrojë në Bruksel edhe për një kohë dhe se sot (e premte) do t'i drejtohet publikut serb. “Ajo që është e rëndësishme është se ne kemi luftuar për paqe, për stabilitet, për zgjidhje kompromisi dhe për shkak të kësaj presidenti Aleksandër Vuçiq do të qëndrojë edhe për kohë të pacaktuar në Bruksel”, ka thënë ai.

Në ndërtesën e BE-së, ku është zhvilluar dialogu, ka qëndruar edhe i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Kujtojmë se pala amerikane nuk merr pjesë në dialog, por ShBA-



## Grenelli pas takimit në Bruksel: Kurti hodhi poshtë çdo ide që presidentët e ShBA-së i dhanë Kosovës

Pas takimit në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq në Bruksel, i cili ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje, ish-i dërguari special i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se dëshiron ta rikujtojë se Kurti ka hedhur poshtë çdo ide që presidentët amerikanë i kanë dhënë Kosovës. “Rikujtim. Albin Kurti ka hedhur poshtë çdo ide që presidentët amerikanë i kanë dhënë Kosovës. Të dy presidentët, ai demokrat dhe ai republikan. Ky është vetëm një fakt”, ka shkruar Grenelli në “Twitter”.

**EPOKA E RE**

**Lirim GECI**

Bruksel, 18 gusht - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të enjten në Bruksel, në kuadër të dialogut në mes të dy shteteve. Ky takim, i cili është zhvilluar në dy raunde, është ndërmjetësuar dyshja evropiane Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak. Paraprakisht, pas raundit të parë, shefi i diplomacisë i BE-së, Josep Borrell dhe i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, kanë biseduar ndaras me Kurtin dhe Vuçiqin. Po ashtu, me Kurtin dhe Vuçiqin ka biseduar ndaras edhe emisari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, i cili ka shkruar në Bruksel për

shkak të dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimeve, përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, ka bërë me dije se Kosova dhe Serbia nuk kanë arritur një marrëveshje për çështjen e targave dhe dokumenteve serbe. Por, ai ka thënë se palët janë pajtuar që t'i vazhdojnë diskutimet në ditët në vazhdim pasi, siç ka thënë ai, ka “ende ka kohë” dhe se BE-ja “nuk heq dorë” nga insistimi që dy shtetet të arrijnë kompromis. Borrelli ka thënë se takimet në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e BE-së, nuk ishin “takime të zakonshme”, por “takime për menaxhimin e krizës”. “Ne pamë rritje tensionesh për vendimin e



## Kurti insiston për reciprocitet me Serbinë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar në mbrëmjen e së mërkurës me të dërguarin e Bashkimit Evropian (BE) për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak dhe të dërguarin e Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Kurti ka thënë para medieve se në takim me Lajçakun dhe Escobarin është diskutuar për "elemente të kornizës për marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve që duhet ta ketë në qendër njohjen reciproke si dhe për çështjet aktuale". "Pritet të trajtohen të

gjitha marrëdhëniet bilaterale, me të gjitha vështirësitë dhe pengesat", ka thënë Kurti. Ai ka insistuar që Kosova është për reciprocitet me Serbinë. I pyetur nëse ka mundësi që Kosova ta shtyjë sërish zbatimin e vendimeve për targat dhe dokumentet serbe, Kurti ka

thënë se "ne po diskutojmë për zgjidhje, jo për shtyrje". "Nuk është se e kemi bërë shtyrjen që të bëjmë edhe shtyrje të tjera. Shtyrja është bërë më 31 korrik për datën 1 shtator, dhe me atë rast kemi dëshmuar - me datën 1 gusht - se nuk konfiskojmë dokumente, siç ka qenë fushata

e dezinformimit. Në anën tjetër, është e mundshme që më 1 shtator nuk do të lëshojmë dokumente, sepse edhe Serbia do të heqë dorë prej lëshimit të dokumenteve në vendkalimet kufitare me Kosovën. Ne dëshirojmë marrëdhënie reciproke", ka thënë Kurti.

ja mbështet plotësisht përpjekjet e BE-së në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Ky ishte takimi i tretë midis Kurtit dhe Vuçiqit në Bruksel, pasi në qershor dhe korrik të vitit 2021 dy takimet kishin përfunduar pa ndonjë rezultat. Një ditë para takimit, në selinë e NATO-s në Bruksel, shefi i kësaj organizate, Jens Stoltenberg, i ka pritur ndaras Kurtin dhe Vuçiqin. Pas takimeve, Stoltenbergu ka thënë se i takon Prishtinës dhe Beogradit ta shmangun përshkallëzimin e situatës. Po ashtu, ai ia ka bërë të qartë Serbisë se KFOR-i në Kosovë është i gatshëm të ndërtojë nëse cenohet siguria. Ndërsa kryeministri Kurti ka kërkuar anëtarësimin e Kosovës në NATO.

### Vuçiqi i thërret në takim përfaqësuesit e serbëve nga Kosova

Derisa ishin duke u zhvilluar takimet në Bruksel, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thirrur një takim me përfaqësuesit e serbëve nga Kosova, i cili do të mbahet të dielën, më 21 gusht, në Beograd. Në këtë takim janë ftuar përfaqësues të Listës Serbe, kryetarë komunash dhe drejtorë të spitaleve në zonat në Kosovë të banuara me shumicë serbe. "Nesër (e premte), me të kthyer



në Beograd, Vuçiqi do t'i drejtohet kombit dhe ky do të jetë një ndër fjalimet e tij më të rëndësishme. Kjo do të ndodhë pasdite ose në mbrëmje", ka thënë Petar Petkoviçi. Ndërsa në Mitrovicën e Veriut të banuar me shumicë serbe, gjatë kohës sa po zhvilloheshin takimet në Bruksel, janë parë disa grafito me porosinë: "Mos u shqetësoni! Ne jemi këtu! Ne po presim!". Këto grafito janë nënshkruar nga "Brigada e Veriut".

### Hulumtimi tregon se në Serbi po rritet përkrahja për pavarësinë e Kosovës

Instituti i Beogradit për Çështje Evropiane ka bërë një hulumtim të opinionit publik në Serbi. Në këtë hulumtim të publikuar janë përfshirë 1 228 persona, dhe pyetjet për ta kanë qenë kryekëput të lidhura me raportin Kosovë - Serbi. Ajo çfarë vërehet në leximin e rezultateve, është se, krahasuar me vitin 2021, në Serbi ka rritje të

numrit të qytetarëve të cilët e përkrahin pavarësinë e Republikës së Kosovës. Në pyetjen "A do ta mbështesnit një plan të presidentit Aleksandër Vuçiq, i cili do ta njohte pavarësinë e Kosovës, dhe do të siguronte një shtet të qëndrueshëm dhe standard më të mirë për qytetarët e Serbisë?", në vitin 2021 për "PO" kanë qenë 21

për qind e të anketuarve, derisa në vitin 2022 kjo përqindje ka shkuar në 26.3, duke shënuar një rritje prej 5.3-përqindësh. Ndërkohë është rritur edhe përqindja e serbëve të cilët mendojnë se Serbia e ka humbur Kosovën. Në vitin 2021 kjo përqindje ka qenë 39.5, ndërsa në vitin 2022 ka shkuar në 44.2 për qind.

## 40 pacientë me Covid po trajtohen në QKUK dhe spitale

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se 40 pacientë janë duke u trajtuar me Covid-19 në kuadër të QKUK-së.

Në Klinikën Infektive janë duke u trajtuar shtatë pacientë,

ndërsa një është në Mjekim Intensiv me oksigjeo-terapi. Në Klinikën e Pediatriisë janë duke u trajtuar katër fëmijë, në Mjekim Qendror janë dy raste të intubuara.

Sipas ShSKUK-së, në spitale rajonale janë duke u trajtuar gjithsej 26 pacientë.

Në Spitalin e Gjakovës e të Prizrenit janë duke u trajtuar gjashtë qytetarë, ndërsa në Spitalin e Pejës po trajtohen tetë pacientë. Edhe në Spitalin e Gjilanit po trajtohen pesë pacientë, ndërsa në Spitalin e Mitrovicës i shtrirë është vetëm një pacient.



## Kastrati takon drejtorët e shkollave të komunës së Malishevës

MALISHEVË, 18 GUSHT (E) - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtorisë për Arsimit dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, kanë takuar të enjten drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore të kësaj komune në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2022/2023.

Në një fjalë rasti, kryetari Kastrati ka kërkuar nga drejtorët e shkollave të jenë të përkushtuar në punë. "Respektojeni etikën komunikuese në institucione dhe jashtë tyre, kodin e veshjes, bashkëpunimin brenda shkollës me mësimdhënës dhe nxënës, me prindër dhe me institucionin e Drejtorisë së

Arsimit, orarin e punës dhe t'i përmbushni pritjet e sukseset që keni planifikuar me mësimdhënës dhe nxënës", ka thënë ai.

Gjithashtu, kryetari Kastrati ka thënë se ky vit do të jetë vit i vështirësive të natyrave të ndryshme me të cilat do të ballafaqohen, konkretisht i furnizimit me energji elektrike, lëndë djegëse etj. "Ne si qeveri lokale i kemi bërë të gjitha përgatitjet për ta tejkaluar këtë situatë me të cilën mund të përballlemi, që me fillim të vitit të ri shkollor, por mësimi duhet të fillojë ashtu siç është planifikuar me kalendarin shkollor", ka thënë Kastrati.

Ndërsa drejtoresha për Arsimit



dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, ka folur rreth përgatitjeve që kanë bërë për fillimin e procesit mësimor me

kohë. Në fund, kryetari Kastrati dhe drejtoresha Krasniqi ua kanë dhënë kontratat drejtorëve të cilët janë zgjedhur

përmes konkursit publik dhe konform legjislacionit në fuqi për pozitat udhëheqëse në shkollat e tyre.

## Në Serbi regjistrohen 31 raste me linë e majmunëve



BEOGRAD, 18 GUSHT - Në periudhën prej 17 qershorit, kur është regjistruar rasti i parë në Serbi, deri më 17 gusht 2022 janë konfirmuar 31 raste me linë e majmunëve.

Të gjithë personat e infektuar janë meshkuj, të moshës 21 deri në 44 vjeç, ka njoftuar Instituti i Shëndetit Publik në Serbi më 18 gusht.

Në Beograd janë regjistruar 27 nga 31 rastet me linë e majmunëve. Tre persona kanë pasur nevojë për trajtim spitalor, ndërsa pjesa tjetër janë trajtuar në shtëpi.

Në përgjithësi linë e majmunëve shkakton simptoma të lehta, përfshirë: ethe, dhimbje dhe puçra në lëkurë të mbushura me qelb. Sipas OBSH-së, njerëzit kryesisht shërohen në

një periudhë prej dy deri në katër javë.

Që nga 7 gushti 2022, sipas buletinit të fundit të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, në 89 vende të botës janë konfirmuar 27 814 raste dhe 11 vdekje nga linë e majmunëve".

Rreziku i lisë së majmunëve globalisht është i moderuar, me përjashtim të Evropës, ku OBSH-ja e ka vlerësuar të lartë.

Më së shumti raste me linë e majmunëve u raportuan në Spanjë (5 179), Gjermani (3 142), Francë (2 673) dhe Holandë (1 029). Përhapja e lisë së majmunëve është shpallur një emergjencë globale shëndetësore nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 23 korrik.

## Kosova regjistron një viktimë dhe rreth 500 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 18 GUSHT - Një person ka vdekur dhe 483 të tjerë janë infektuar me Covid në Kosovë në 24 orët e fundit ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë (MSh). Sipas njoftimit të MSh-së, rastet e reja kanë dalë pas testimit të 1 598 mostrave, apo 30 22 për qind e testeve kanë rezultuar pozitivë për Covid.

Numri i infektiveve është më i ulët krahasuar me një ditë më

parë, kur u regjistruan 783 raste. Po ashtu, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 1 196 persona, ndërsa raste aktive janë 4 874.

Kosova po vazhdon vaksinimin kundër koronavirusit pavarësisht se numri i personave që po vaksinohen është i ulët. Autoritetet shëndetësore kanë bërë me

dije se vetëm në 24 orët e fundit kanë administruar 45 vaksina kundër koronavirusit.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga moshë 12-vjeçare. Nga moshë 18 e sipër qytetarët mund të vaksinohen me tri doza të vaksinës, ndërsa ata mbi 60 vjeç dhe personat më të ndjeshëm mund të imunizohen edhe me dozën e katërt.



## Tahiri: Projektligji për Zyrtarët Publikë s' duhet të kalojë

Prishtinë, 18 gusht - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka reaguar pas procedimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Administratës Publike. Ai këtë projektligj e ka quajtur sulm mbi administratën shtetërore. Sipas tij, nenet 46, 66 dhe 98 janë kundërkushtetuese. "Duke e lexuar Projektligjin e ri

për Zyrtarët Publikë, jam i tmerruar me provizionet që parapërcaktojnë dhe lejojnë hapësirë për ndërhyrje politike në administratë publike. Ky projektligj qenka një sulm i drejtpërdrejtë ndaj administratës shtetërore dhe shërbimit civil, pa përjashtim. Është kundër gjithçka që është arritur me BE-në dhe 'Sigma' në

dekadën e fundit. Projektligji i ri për zyrtarët publikë, respektivisht neni 46, neni 66 dhe neni 98, te dispozitat kalimtare, janë qartazi nene kundërkushtetuese, që në esencë janë fshesë e hekurt kundër menaxhmentit drejtues të administratës shtetërore. Ky ligj nuk duhet të kalojë asses!", ka thënë Tahiri.



## Nagavci: Të gjithë punëtorët e arsimit janë trajtuar me kujdes të veçantë në Projektligjin për Paga



PRISHTINË, 18 GUSHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI), Arbërie Nagavci, ka thënë se në Projektligjin për Paga, të gjitha kategoritë e punëtorëve të arsimit janë trajtuar me kujdes të veçantë. "Të gjitha kategoritë e punëtorëve të arsimit janë trajtuar me kujdes të veçantë në Projektligjin e Pagave, i cili tanimë është në diskutim paraprak. Me rastin e hartimit të projektligjit janë marrë për bazë rekomandimet e MASHTI-t si dhe janë trajtuar edhe ato kategori të punëtorëve të arsimit të cilat ishin lënë anash në ligjin e shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese", ka njoftuar ministria Nagavci. Nagavci ka thënë se ky projektligj dallon shumë nga

ligji i mëhershëm, ndërsa efekti i drejtpërdrejtë i tij, sipas saj, do të jetë përmirësimi i pozitës së punëtorëve të arsimit, motivimi i tyre për performancë sa më të mirë dhe drejtësi e barazi. Ndër të tjera, Projektligji i Pagave, sipas Nagavci, sjell: "Koefficiente të dinjitetshme për punonjësit e arsimit të të gjitha niveleve, trajtim të barabartë të mësuesve klasorë dhe mësime të mëdha të arsimit në mesëm të ulët, shtesa në paga në bazë të kualifikimit dhe përgjegjësi menaxheriale, përcaktim të vlerës së koefficientit në bazë vjetore dhe transparencë të plotë të pagave në sektorin publik. Angazhimi i të gjithë neve duhet të jetë te fillimi i suksesshëm i vitit të ri shkollor më 1 shtator".

## Hapet festivali i artizanaleve dhe ushqimeve tradicionale në Mitrovicë

MITROVICË, 18 GUSHT (ER) - Është hapur festivali i artizanaleve dhe ushqimeve tradicionale në sheshin "Isa Boletini" në Mitrovicë. Ky festival është hapur në kuadër të "Ditëve të Diasporës".

Në hapjen e këtij festivali kanë marrë pjesë kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Vesa Broja dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi.

Në fjalën e saj, drejtoresha Idrizi ka theksuar se në këtë vit ka pasur aktivitete të shumta dhe të larmishme si asnjëherë më parë, duke shtuar se festivali i këtij lloji

do të ndikojë te bashkatdhetarët tanë t'i ruajnë lidhjet, rrënjët e traditat, por edhe ta fuqizojnë identitetin kulturor.

Ky festival është organizuar nga OJQ "Mundësia" në bashkëpunim me OJQ Shoqata Multietnike e Grupeve të Grave të Rajonit të Mitrovicës dhe është mbështetur financiarisht përmes thirrjes publike nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Pjesëmarrësit në këtë festival kanë mundësi t'i praktikojnë poçarinë, endjen me vek, punimet nga druri, thurjet, si dhe gatimet e ndryshme tradicionale.



## Haxhiu: Jashtëzakonisht e shqetësuar me dhunën ndaj grave



PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se është jashtëzakonisht e shqetësuar me dhunën fizike dhe emocionale të ushtruar ndaj grave. Sipas saj, çdo formë e dhunës ndaj vajzave, grave dhe fëmijëve duhet trajtuar seriozisht dhe menjëherë. "Jam jashtëzakonisht e shqetësuar

me dhunën fizike dhe emocionale të ushtruar ndaj grave, vajzave e fëmijëve. Fatkeqësisht, është rrënjësor aq thellë në shoqërinë tonë, sa dhunuesit mund ta ushtrojnë atë publikisht, pa asnjë pikë problemi. Nëse dhunuesit dhunën fizike e ushtrojnë edhe publikisht, e marrim me mend se çfarë ndodh prapa dyerve të mbyllura! Çdo formë

e dhunës ndaj vajzave, grave dhe fëmijëve duhet trajtuar seriozisht dhe menjëherë. Për rastin e dhunës fizike në Prizren u kam raportuar policisë dhe prokurorisë dhe pres që institucionet ta trajtojnë me prioritet këtë rast, dhe viktimat e qytetarët të sigurohen se dhunuesit do të ndëshkohen", ka thënë Haxhiu.

## Sekuestrohen barna të kontrabanduara nga Serbia

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka ndaluar barna të kontrabanduara nga Serbia. Sipas njoftimit të policisë, të dyshuarit serb i është gjetur një sasi e madhe e barnave të padeklaruara. "Policia

kufitare gjatë realizimit të detyrave dhe autorizimeve në menaxhimin dhe kontrollin kufitar në hyrje të Kosovës të 'Dheu i Bardhë', ka ndaluar për kontroll të përbashkët me Doganën e Kosovës automjetin e markës 'Citroen

C3', ngjyrë hiri, të cilën e drejtonte i dyshuari mashkull serb dhe gjatë kontrollit në automjet, në një çantë laptopi, i është gjetur një sasi e konsiderueshme e barnave të cilat kishin banderola të Serbisë dhe të njëjtat nuk

ishin deklaruar paraprakisht. Bazuar në kompetencën lëndore, barnat i janë sekuestruar nga Dogana e Kosovës dhe ndaj personit është iniciuar procedura për kundërvajtje doganore", ka njoftuar policia.



## Kundërshtohet shtrenjtimi i rrymës, paralajmërohen protesta

PRISHTINË, 18 GUSHT - Qytetari nga Prishtina, Visar Dili, ka filluar kampanjën kundër propozimit për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Aktivisti dhe iniciatori i kësaj platforme ka thënë se kampanja e nisur nga e shtuna do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim. Ai dhe shumë qytetarë janë duke shprehur kundërshtinë e tyre përmes platformës online, duke paralajmëruar edhe protestë para institucioneve përkatëse.

Dili, që është nënkryetar i rinisë së AAK-së, ka thënë se kampanja e nisur nga ai ka gjetur përkrahje te qytetarët. "Kampanja ka të bëjë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Pra, siç e dimë, nga e shtuna janë informuar

qytetarët se do të ketë shtrenjtim të energjisë elektrike për 100 për qind. Në kuadër të kësaj ne kemi nisur kampanjën kundër shtrenjtimit të energjisë në 'Facebook', ku ka marrë një hov shumë të madh. Popullata është duke na përkrahur dhe kemi më shumë se 1 000 'hashtags' në rrjetet sociale. Qytetarët janë të mobilizuar dhe janë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike", ka thënë ai për "EO".

Sipas Dilit, një rritje e tillë do ta prekë mirëqenien e qytetarëve dhe për këtë shkak ai ka paralajmëruar edhe protestë. "Ne para dy ditësh e kemi mbajtur një aksion para qeverisë, ku kemi ndezur disa qirinj duke formësuar fjalën 'kundrejt', pra kundrejt



shtrenjtimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, do të kemi aksione në vazhdimësi deri në protesta. Pra nëse vazhdojmë të hasim në vesh të shurdhër, do të ftojme protesta masive të

qytetarëve", ka thënë Dili. Kujtojmë që Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRRE) ka publikuar para dy ditësh propozimin e KESCO-s në lidhje me rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Kompania furnizuese me rrymë ka kërkuar dyfishimin e vlerës së tarifave të energjisë elektrike, duke dorëzuar kërkesën në ZRRRE për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave.

## Shala për krizën energjetike: Të ndërpritet pagesa për veriun, të respektohet Kushtetuta

PRISHTINË, 18 GUSHT - Drejtori i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Behxhet Shala, ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të ndaj mjete për pagesën e rrymës për serbët e veriut të vendit. Madje ai ka shtuar se kanë reaguar me vite të tëra, por që një kërkesë e tillë nuk është marrë parasysh nga asnjë qeveri, as tash nga kryeministri Albin Kurti. Megjithatë, ai ka theksuar se të gjithë qytetarët duhet të trajtohen sipas Kushtetutës e cila garanton barazi para ligjit.

Për shkak të mungesës së vullnetit politik, ai ka thënë se të gjitha qeveritë kanë vazhduar t'i privilegjojnë serbët e veriut duke i furnizuar me energji nga taksat e qytetarëve të pjesës



tjetër të vendit. "Ne kemi reaguar shumë herë me vite të tëra. Ne kemi pasur takime edhe me ministrin edhe me kryeministrin ku kemi kërkuar

që qytetari i Kosovës duhet të trajtohen sipas Kushtetutës së Kosovës dhe e cila garanton barazi para ligjit për të gjithë qytetarët pavarësisht prej

pavarësisë etnike. Mirëpo, për shkak të një mungese të vullnetit politik, të gjitha qeveritë, duke përfshirë edhe qeverinë Kurti 2, kanë vazhduar

t'i privilegjojnë serbët e veriut të cilët marrin para edhe nga buxheti i Kosovës, edhe nga buxheti i Serbisë dhe 100 % i shërbejnë Serbisë", ka thënë Shala për "EO", duke shtuar se Kurti ka ardhur në pushtet me premtimin se nuk do ta paguajë rrymën për veriun.

"Ndërkaq institucionet e Kosovës në vend se të marrin një qëndrim i cili është në përputhje me ligjin, i favorizojnë dhe diskriminojnë qytetarët shqiptarë të cilët janë pagues të rregullt të rrymës dhe të cilët nuk kanë as kushte minimale. Kjo qeveri ka ardhur me premtim se nuk do ta paguajë rrymën, ndërkaq para një jave ua ndau KESKO-s 40 milionë euro para për t'ua paguar rrymën serbëve të veriut", ka deklaruar Shala.

## BSPK-ja shpall grevë të përgjithshme nga 25 gushti

PRISHTINË, 18 GUSHT - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka shpallur të enjten grevë të përgjithshme për shkak të mosrealizimit të kërkesave të tyre nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, ka thënë se obligohen që të gjithë punëtorët hyjnë në

grevë. Ai ka thënë se greva do të nisë nga 25 gushti dhe do të zgjasë derisa të përmbushen kërkesat e tyre. "Kërkojmë 100 euro shtesë derisa të miratohet Ligji për Paga. Më 10 gusht 2022 BSPK-ja ka mbajtur mbledhjen e jashtëzakonshme me qëllim të sigurimit të situatës. BSPK-ja përsëri ka ndjekur të gjitha

rugët ligjore drejt realizimit të kërkesave, por nuk ia doli të ulet me qeverinë dhe të gjejmë një rugë të duhur. Prandaj sot dua t'ju informoj se ligji është ai që na obligon të hyjmë në grevë, dhe për këtë shkak sot po e shpallim grevën e përgjithshme për shkak të mosrealizimit të kërkesave", ka thënë Hykolli.





# Në mesin e krizave të mbivendosura, Evropa po përballet me një vakum lidërshipi

Nga Mujtabe RAHMAN  
"Politico.eu"

Bashkimi Evropian është përballur me një mungesë të vërtetë të lidërshit, në një kohë që po përballet me një seri potencialisht shpërthyes të krizave të ndërlidhura ushtarake, diplomatike, energjetike dhe ekonomike. Përparimet në BE janë shënuar tradicionalisht në kohë krize, por një udhëheqës apo një grup udhëheqësish ka qenë gjithmonë i disponueshëm në të kaluarën për të menaxhuar interesat dhe pikëpamjet e ndryshme drejt arritjes së konsensusit.

Sot është e vështirë të shihet se kush do ta ketë fuqinë apo besueshmërinë për të luajtur këtë rol këtë vit dhe vitin e ardhshëm, teksa pasojat e brendshme akute të pushtimit rus të Ukrainës – rritja e serioze e inflacionit, mungesa e energjisë dhe e disa produkteve ushqimore, racionimi i mundshëm, madje edhe recesioni ekonomik – do të fillojnë të ndihen shumë.

Ideja se madhësia dhe fuqia ekonomike e Gjermanisë, e bëjnë atë fuqinë e paracaktuar të BE-së, nuk ka qenë asnjëherë e sigurt pasi Berlioni nuk ka qenë i prirur të marrë një rol udhëheqës në BE. Udhëheqja e unionit nënkupton identifikimin, promovimin dhe shitjen e zgjidhjeve përballë opozitës nga vendet e tjera të BE-së.

Thelbi i "merkelizmit" ishte diçka e ndryshme: "Udhëheqje nga qendra", pra një qasje më pasive dhe e kujdesshme e fokusuar në ndërtimin e konsensusit rreth pikëpamjes së shumicës, në vend të guximit dhe kreativitetit në kundërpërgjigjen ndaj sfidave të reja. Kancelari i ri gjerman, Olaf Scholz, është edhe më "merkelian" se sa ishte vetë Angela Merkel.

Ai nuk ka fuqinë politike që gëzonte dikur Merkel, dhe as ambicien apo interesin për ta reformuar BE-në sipas vizionit gjerman. Por problemet e lidërshit të Gjermanisë sot shkojnë përtej karakterit të kancelarit të saj. Ato janë strukturore dhe lidhen me pozicionin e ri të Gjermanisë në BE, dhe jo me politikën e personalitetit të liderit të saj.

Pushtimi i Ukrainës nga Rusia është kriza e parë evropiane, në të cilën Gjermania është "kërkuesi" dhe jo mbrojtësi i BE-së. Në krizën e eurozonës nga viti 2009 e tutje, fuqia financiare e Berlinit ishte asemi vendimtar i unionit. Në krizën e migracionit të vitit 2015, ishte gatishmëria e Gjermanisë për të pranuar pjesën më të madhe të refugjatëve sirianë. Kur Rusia pushtoi Ukrainën për herë të



parë në vitin 2014, ishte diplomacia e aftë e Merkelit, e mbështetur nga gatishmëria e Gjermanisë për të përballuar sanksionet, ajo që nxiti reagimin e BE-së ndaj Moskës. Por krizat e sotme janë të ndryshme.

Për shkak të varësisë së saj energjetike nga Rusia, Gjermania duhet të mbështetet tani tek "solidariteti" i partnerëve të saj në BE. Ndërsa Gjermania mund të ofrojë më shumë mbështetje ushtarake për Ukrainën, zyrtarët e lartë gjermanë mbeten skeptikë nëse mund të arrihet një "fitore ukrainase" dhe për nivelin e përshkallëzimit që do të sillte ajo.

Vetë Scholz ka deklaruar shpeshherë se Gjermania nuk do të tejkalojë asnjëherë vendet e tjera të NATO-s kur bëhet fjalë për ndihmën ushtarake, dhe se një rol "i veçantë" për Gjermaninë në këtë aspekt do të ishte një "gabim".

Kjo qasje ka kontribuar në humbjen e epërsisë morale të Gjermanisë, që ka qenë asemi i saj kryesor në krizat e mëparshme. Në vitin 2009, politika financiare shtrënguese e Gjermanisë, u prezantua si një virtut moral. Por lufta në Ukrainë ka sjellë kolapsin e politikës afatgjatë të Berlinit ndaj Rusisë, duke e dobësuar legjitimitetin e saj por edhe aftësinë për të ofruar zgjidhje apo udhëheqje.

Por problemet e Evropës janë më të mëdha se Gjermania. Me luftën në Ukrainë që po i afrohet muajit të shtatë, dhe me krizën energjetike në zgjerim e sipër, edhe Franca ka nisur të heqë dorë nga ky lidërshipin për shkak të një gjendje

pasigurie dhe brishtësie rë brendshme politike.

Emmanuel Macron do të ishte një kandidat i dukshëm për të mbushur vakumin e lidërshit të BE-së. Por më 19 qershor, ai u bë presidenti i parë francez në 30 vjet që nuk ka një shumicë parlamentare (pasi u bë më 24 prill presidenti i parë francez në dy dekada që u rizgjodh në detyrë).

Tani Macron përballet me një peizazh politik të fragmentuar në mënyrë të barabartë midis të majtës radikale, qendrës konsensuale dhe të djathtës ekstreme. Kufiri i ri midis qendrës dhe të djathtës nacionaliste-populiste, kalon përmes Republicanins të qendrës së djathtë.

Ndërsa është e mundur që ajo të ndahet përgjatë kësaj vijë ndarëse në muajt në vijim, edhe kjo nuk do t'i japë domosdoshmërisht Macron përforcimin e mjaftueshme për një shumicë të qëndrueshme në Asamblenë Kombëtare. Prandaj, presidenti francez do të shpërqendrohet shumë më tepër nga problemet në shtëpi. Ai përballet me një parlament të zemëruar dhe armiqësor, që do të luftojë me dhëmbë e thonj kundër programit të qeverisë së tij, sidomos reformave të diskutueshme ekonomike dhe sociale që ai synon të miratojë kur parlamenti të ri-mblidhet në sesionin e ri në tetor.

Këto politika do të kundërshtohen edhe "në rrugë" nga marshimet dhe grevat e sindikatave, duke filluar që nga shtatori. Këto të fundit kanë qenë gjithnjë të pashmangshme. Por në peizazhin e ri politik, ato ka të ngjarë të bëhen edhe më

intensive.

Pra, Macron përballet me një zgjedhje: të shpërndajë parlamentin aktual ose ta pranojë atë, duke e kaluar e mandatit të tij të dytë 5 vjeçar si president i çalë. Duke pasur parasysh ambicinet e tij, ka gjithnjë e më e shumë gjasa që ai të thërrasë zgjedhje të reja parlamentare në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, një veprim sfidues që do ta dëmtojë gjithashtu aftësinë e tij për ta udhëhequr BE-në.

Por nuk janë vetëm problemet e brendshme të Macron, ato që do të kontribuojnë në deficitin e lidërshit evropian. Me apo pa të drejtë, perceptimi se ai është tepër i butë ndaj Rusisë, e ka minuar atë dhe axhendën e tij të "autonomisë strategjike", pra besimin e Macron se BE-ja duhet të rrisë kapacitetet strategjike dhe ushtarake, për të qenë në lartësinë e peshës së saj globale, ndërkohë Polonia, Ballkani dhe shtetet anëtare nordike, e konsiderojnë veten palë në konfliktin me Ukrainën. Kjo pikëpamje ka vazhduar, edhe pse Macron ka deklaruar në intervistat dhe deklaratat e fundit se konflikti në Ukrainë do të zgjasë për shumë muaj, dhe se Franca do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën me ndihmë ushtarake, financiare dhe humanitare, derisa të arrihet "fitorja" me kushte të pranueshme për Kievin.

Zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen në Itali më 25 shtator, krijojnë gjithashtu destabilitet politik në një nga shtetet më të mëdha anëtare të BE-së, jo vetëm sepse ka të ngjarë që qeveria e ardhshme të jetë një koalicion i ekstremit të djathtë, i udhëhequr nga


populistët e Fratelli d'Italia, Lega dhe Forza Italia.

Si kryeministër, Mario Draghi nuk ushtroi asnjëherë lidërshipin që tregoi në Bankën Qendrore Evropiane. Në rastin më të mirë, ai ishte një garantues i stabilitetit. Por me largimin e tij, Italia nuk ka më gjasa të japë as një kontribut minimal pozitiv në vendimmarrjen apo ndërtimin e konsensusit brenda BE-së.

Përkundrazi, Roma do të bëhet sërish një burim shqetësimi, pasi qeveria e re do të jetë më pak e gatshme të zbatojë reforma ekonomike në këmbim të marrjes së pjesës së saj të fondeve nga paketa e BE për rimëkëmbjen ekonomike të unionit nga pandemia, ku vetëm kësti i parë për Italinë do të jetë 19 miliardë euro, ose rreth 1 për qind e PBB-së së vendit.

Një qeveri euroskeptike e ekstremit të djathtë mund të bjerë në fund dakord me reformat e kërkuara nga BE, por procesi do të jetë plot uljengritje dhe i dhimbshëm. Është e vërtetë se BE-ja nuk ka asnjë "udhëheqës". Por është po aq e vërtetë, që shtetet anëtare të vogla dhe të mesme të unionit, nuk e pranojnë me të drejtë sugjerimin se i përkasin "gradave të tjera", në një kohë që Gjermania, Franca dhe Italia përfaqësojnë "klasën e oficerëve".

Por shtetet e vogla dhe të mesme janë vetë të ndara midis veriut dhe jugut, lindjes dhe perëndimit. Tani mund të jetë momenti i tyre. Por cili prej tyre do të ketë guximin apo besueshmërinë për të udhëhequr?



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## “Albi Mall”, sponsor gjeneral i Superligës së Kosovës në futboll

PRISHTINË, 18 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës ka nënshkruar kontratën dyvjeçare me qendrën më të madhe tregtare në vend, “Albi Mall”, që do të jetë sponsor gjeneral i Superligës së Kosovës në futboll. Për dy vjet radhazi elita e futbollit tonë do të quhet Albi Mall Superliga. Kontratën e partneritetit e kanë nënshkruar presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe drejtori ekzekutiv i “Albi Commerce”, Sutki Humolli. Me rastin e nënshkrimit të kontratës, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, u shpreh i lumtur që sot u zyrtarizua partneriteti me “Albi Mall”, si njëra nga korporatat më të suksesshme dhe më serioze në vendin tonë, e cila çdo vit shënon rritje. “FFK vazhdon të punojë me përkushtim të madh për avancimin e futbollit në të gjitha segmentet dhe në këtë drejtim fatmirësisht e kemi gjetur edhe përkrahjen e kompanive të ndryshme, të cilat pa hezitim po i bashkohen misionit tonë në rritjen e mëtejme të futbollit. Me këtë rast, e falënderoj ‘Albi Mall’-in për gatishmërinë dhe interesimin e tyre për ta mbështetur futbollin tonë nëpërmjet sponsorizimit të Superligës. Partneriteti i tillë është i mirëseardhur dhe u shërben interesave të të dyja palëve. Gjithsesi, nga ky partneritet përfiton futbollit ynë, për të cilin secili prej nesh po e jep kontributin në forma të ndryshme. Besoj se së bashku me ‘Albi Mall’ do të ndikojmë që liga jonë elitare të shënojë rritje të mëtejme në organizim dhe në cilësi të lojës së futbollit”, ka thënë presidenti Ademi.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i “Albi Commerce”, Sutki Humolli, është shprehur i lumtur që brendi i tyre do të jetë sponsor i Superligës për dy vjet radhazi: “Kjo kontratë që na takoi sot



këtu është një nga bashkëpunimet më të mira për ne si ‘Albi Mall’, duke qenë se po investojmë në kulturën e sportit kosovar. Bashkëpunimi me Federatën e Futbollit të Kosovës na bënë të kuptojmë se futbollit përveçse është emocion në vete, tashmë do të përfaqësohet me emërimin ‘Albi Mall Superliga’, që i ka bashkuar edhe dy fuqi shumë përgjegjëse, prandaj edhe

angazhimi ynë që të jemi pjesë e kësaj federate dhe të investojmë në kulturën e sportit kosovar ka qenë vendim unanim nga të gjithë, që të jemi sa më afër mundësisë së zhvillimit të kulturës sportive në Kosovë. Faleminderit të gjithëve sot për praninë tuaj, Federatës së Futbollit të Kosovës suksese dhe do të na keni gjithnjë përkrahje!”, ka theksuar Humolli.

### SHKURT

#### Bekaj: Do ta respektoj kontratën me Tiranën deri në ditën e fundit

Portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Visar Bekaj, ka konfirmuar se nuk do të transferohet në Turqi, por që karrierën futbollistike do ta vazhdojë në Shqipëri. “Do të jem te Tirana për të paktën edhe një sezon. Kam kontratë dhe do ta respektoj deri në ditën e fundit”, ka thënë Bekaj, i cili në të kaluarën me sukses ka mbrojtur ngjyrat e Prishtinës në Superligën e Kosovës.

#### Vojvoda rikthehet nga lëndimi

Skuadra e Torinos ka marrë lajme të mira para ndeshjes së fundjavës me Lazion, pasi mbrojtësi Mërgim Vojvoda është rikthyer nga lëndimi dhe është në dispozicion të trajnerit. Mediet italiane kanë raportuar se mbrojtësi i Kosovës është stërvitur me grupin dhe është i gatshëm të kontribuojë në fushën e gjelbër. Vojvoda është mbrojtës i krahut të djathtë, por luan edhe në krahun e majtë të mbrojtjes. Trajneri Juriq ka besim të madh në mbrojtësin “dardan”, i cili ka shkëlqyer kampionatin e kaluar.

#### Sigal Prishtina mëson kundërshtarin në FIBA Cup

KB Sigal Prishtina ka mësuar kundërshtarin potencial në FIBA Cup. Faza kualifikuese e FIBA Europe Cup 2022/23 do të zhvillohet në formë të turneut. Klubi më i suksesshëm në vendin tonë, Sigal Prishtina, është e vendosur në “Turneun B”, ku skuadra CBet Jonava nga Lituania LT është zgjedhur nikoqire e turneut. Turneu do të zhvillohet me 27-30 shtator në qytetin e Jonavës, Lituani. Për shkak të paraqitjeve të suksesshme në të kaluarën në Evropë, skuadra jonë pret në gjysmëfinale fituesin e ndeshjes çerekfinale Cedevita Junior - Kalev/Cramo. Skuadrat e tjera pjesëmarrëse në këtë turne janë: CBet Jonava, SCMU Craiova dhe Kapfenberg Bulls. Nën urdhrat e trajnerit Ekrem Memnun lojtarët po përgatiten maksimalisht që suksesi të mos mungojë.

## FHK-ja liron dy trajnerë nga detyra

PRISHTINË, 18 GUSHT - Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës e ka mbajtur mbledhjen e radhës nën udhëheqjen e presidentit Eugen Saraçini. Në këtë mbledhje bordi ka diskutuar për paraqitjen e përfaqësuesve të reja në kampionatet evropiane të kësaj vere. Bordi ka vlerësuar punën dhe angazhimin e kryetrajnerit të Përfaqësueses U20, Taib Kabashi, dhe të trajnerit të përkohshëm të Përfaqësueses U18, Fatmir Muhaxheri. Bordi ka vendosur që Kabashin dhe Muhaxherin t'i lirojë nga pozita e kryetrajnerëve. Kabashin, në fakt, i ka përfunduar mandati dyvjeçar, kurse Muhaxheri ishte i angazhuar vetëm për Evropianin në Letoni. Ai vazhdon angazhimin në shtabin teknik të Përfaqësueses A. Bordi i FHK-së ka falënderuar Kabashin e Muhaxherin për punën e bërë me shumë zell dhe



përkushtim. Bëhet fjalë për dy personalitete që kanë dhënë shumë dhe vazhdojnë të japin shumë për

hendbollin e Kosovës. Së shpejti bordi do të vendosë për trajnerët e këtyre grupmoshave.

## Rrahmani: Shpresojmë të luftojmë për 'Scudetto'

**NAPOLI, 18 GUSHT** - Edicionin e kaluar Napoli ishte një prej kandidatëve për ta fituar "Scudetton", por u dorëzua në pjesën e dytë të sezonit. Mbrojtësi Amir Rrahmani nuk e ka fshehur dëshirën dhe

ëndrrën e tij për ta fituar titullin e kampionit në Itali. "Është sikur vitin e kaluar, duhet të luajmë ndeshje pas ndeshjeje, të përmirësohemi lojë pas loje. Shpresojmë që në fund të jemi atje lart dhe të luftojmë për

'Scudetto', ka thënë Rrahmani në një intervistë për "Radio Goal", respektivisht në emisionin "Kiss Kiss Napoli". "Edhe vitin e kaluar kemi thënë se të gjithë duhet të jemi liderë në fushë dhe jashtë saj. Duhet

t'i ndihmojmë bashkëlojtarët, kështu rritet skuadra", ka shtuar mbrojtësi nga Kosova. Rrahmani shpreson që Napoli t'i gëzojë tifozët në stadiumin "Diego Armando Maradona" këtë fundjavë ndaj Monzas, në



ndeshjen e parë sezonale në shtëpi.

## FIBA Evropa shpërblen FBK-në

**PRISHTINË, 18 GUSHT** - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është në mesin e pesë (5) federatave nacionale që është shpërblyer nga FIBA Evropa për angazhimin dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm për promovimin dhe vizibilitetin e kampanjës "Her World, Her Rules" (bota e saj, "rregullat e saj") në kuadër të projektit FIBA Europe Girls Program). FBK-ja së bashku me Federatën e Bullgarisë, Greqisë, Maqedonisë së Veriut dhe të Rumanisë janë shpërblyer me nga 5 000 (pesë mijë) euro për përkushtimin në kuadër të kampanjës, përderisa për vitin kalendarik shtator 2022 - korrik 2023, FBK-ja nga ky projekt do të përfitojë në total 28 000 (njëzet e tetë mijë) euro.

Federata e Basketbollit e Kosovës këtë vit kampanjën Her World, Her Rules do ta zhvillojë në bashkëpunim me klubet e Superligës së Femrave, Ligës së Parë të Femrave, Ligave U16 dhe U14, si dhe me disa nga shkollat fillore të të gjitha qyteteve të Kosovës. Sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, në lidhje me shpërblimin nga FIBA Evropa dhe vazhdimin e projektit edhe për një vit për faqen zyrtare të FBK-së, ka thënë: "Prej se FIBA Evropa e ka lansuar projektin FIBA Europe Girls Program dhe kampanjën 'Her World, Her Rules' ne kemi qenë ndër federatat që



më së miri dhe më me vullnet e kemi implementuar këtë projekt nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që kanë bërë që vajzat të merren me basketboll, por edhe të qëndrojnë në basketboll. Ne kemi raportuar në FIBA për këtë projekt pas çdo viti kalendarik të tij, si me raporte të punës ashtu edhe me ato financiare, dhe gjithnjë kemi marrë lëvdata për

punën e bërë si në terren, ashtu edhe në çështje administrative. Ne jemi shumë të lumtur që së pari do ta vazhdojmë projektin edhe për një vit dhe, së dyti, që FIBA Evropa na ka shpërblyer për angazhimin dhe punën e bërë, sepse kjo na motivon edhe më shumë që të vazhdojmë t'i inkurajojmë vajzat e reja të merren me basketboll".

## LeBroni bëhet lojtari më i paguar në histori të NBA-së

**LOS ANXHELOS, 18 GUSHT** - LeBron Jamesi dhe Los Angeles Lakersi kanë rënë dakord për një zgjatje të kontratës dyvjeçare, me vlerë prej 97.1 milionë dollarësh, sipas raporteve. Marrëveshja e bën Jamesin lojtarin më të paguar në NBA ndonjëherë me 532 milionë dollarë të garantuara. Kevin Durant e ka mbajtur deri më tani këtë rekord, me 509 milionë dollarë. Katër herë kampioni i NBA-së mund të zgjedhë të bëhet agjent i lirë në vitin 2024, ose të presë deri në vitin 2025, për të nënshkruar me cilëndo skuadër që tërheq djalin e tij 17-vjeçar, Bronny, i cili pritet të hyjë në ligë atë sezon. Jamesi ka shprehur vazhdimisht dëshirën për të luajtur



së bashku me djalin e tij. James po shkonte në sezonin e fundit të marrëveshjes së tij me një pagë në 2022-2023 prej 44.5 milionë dollarësh, shkruan "DailyMail". Tani ai do të fitojë 46.7 milionë dollarë për

sezonin e ardhshëm, teksa do t'i bashkohet shokut të skuadrës, Antonio Davis, në kontrollin e së ardhmes së tij të afërt. Të dy lojtarët mund të zgjedhin të bëhen agjentë të lirë më 2024 ose 2025.

## Werner: Kjo është e vërteta e largimit nga Chelsea

Timo Werner u largua nga Chelsea pas dy vjetëve qëndrim në "Stamford Bridges". Sulmuesi gjerman nuk arriti asesi të përshtatej me futbollin anglez dhe u rikthye te skuadra gjermane RB Leipzig. Pas

rikthimit në Gjermani, Werner ka zbuluar edhe arsytet e vërtetë që u largua nga londinezët këtë verë. Reprerentuesi gjerman ka thënë se ka qenë i suksesshëm në Londër, por u largua pasi sistemi i lojës së Tuchel nuk i

përshtatej atij. "Për mua, gëzimi i luajtjes futboll është ajo që ka më shumë rëndësi. Unë isha i suksesshëm te Chelsea, por gjatë fundit të aventurës filloi të më zbehej dëshira për të luajtur futboll. Arsyja lidhet me faktin

që nuk po luaja më rregullisht", ka thënë Werner. "Kam idenë që sistemi i lojës së Tuchel nuk më përshtatej, kështu që duhej të hidhja një tjetër hap në karrierë. Unë ndodhem në një moshë ku do të doja të luaja sa

më shumë. Chelsea është suksesi më i madh i karrierës sime dhe do të jetë gjithmonë një klub i veçantë për mua. Vazhdoj t'i mbaj kontaktet me shokët, por më duhej të ndryshoja", ka shtuar Werner.

### SHKURT

#### Presidenti i Formulës 1: Nuk do të ketë më gara në Rusi

"Për të organizuar një garë të Formulës 1, Rusia paguante shuma marramendëse. Gjithsesi, ka gjëra që nuk mund të negociohen, ndaj nuk do të diskutojmë më. Nuk do të ketë më gara të Formulës 1 në Rusi". Është kjo deklarata e bërë nga presidenti i Formulës 1, Stefano Domenicali, për të përditshmen gjermane "Bild", që ka folur për përjashtimin e Rusisë nga botërori si pasojë e pushtimit të Ukrainës. Në pistën e Sochit duhej të garohej më 25 shtator, por tashmë ajo datë është bosh në kalendar. Formula 1 zbarkoi në Rusi në vitin 2014, me një garë në pistën e Sochit, në Detin e Zi, ku më herët ishin organizuar edhe Lojërat Olimpikë dimërore. "Ne do ta përdorim forcën që ka sporti ynë për të qenë pjesë e ndryshimeve në sport dhe përtej tij", ka thënë Domeincali.

#### Joshua 'thumbon' Urykun: Grushtues i mirë lind, nuk bëhesh

Anthony Joshua ka dhënë një paralajmërim të fortë për kundërshtarin e së shtunës, Oleksandr Usyk. Britaniku i është drejtuar ukrainasit duke i thënë se nuk do t'i mjaftojnë stërvitjet e shumta të bëra. Ai madje i ka thënë 35-vjeçarit se i gjithë ky mund do të kontribuojë edhe më shumë në rëndimin e situatës për të. "Ngritja e peshave dhe e gjithë kjo nuk ju bën vërtet një grushtues të mirë. I gjithë ky mund do t'ju 'ndihmojë' të humbni më lehtë. Grushtues i mirë lind, nuk bëhesh", ka thënë Joshua. Ndeshja në mes të tyre do të zhvillohet të shtunën në Arabinë Saudite.

#### Napoli paraqet Simeonen

Napoli ka konfirmuar zyrtarisht se ka nënshkruar me sulmuesin Giovanni Simeone nga Hellas Verona. Klubi napolitan ka vazhduar përforsimet pas disa largimeve të mëdha si Lorenzo Insigne, Dries Mertens dhe Kalidou Koulibaly. I fundit që do të zbarkojë në stadiumin "Diego Armando Maradona" është pikërisht një argjentinas. Bëhet fjalë për sulmuesin Giovanni Simeone, i cili transferohet nga Hellas Verona, pas një supersezone të fundit në Serinë A. "Mirë se vjen, Cholito!", shkruan në postimin e shkurtër në faqen zyrtare të Napolit. Simeone thuhet se i bashkohet Napolit në formë huazimi me pagesë prej 3.5 milionë eurosh dhe me detyrim blerje për një tarifë prej 12 milionë eurosh.

#### Perez: Mbappe është bërë pishman që nuk erdhi në Real

Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez, është bërë sërish protagonist me batutat e tij. Këtë herë ai është marrë me sulmuesin e PSG-së, Kylian Mbappe. Vetëm pak ditë më parë, i pyetur nga një tifoz për rikthimin e mundshëm të Cristiano Ronaldos në Madrid, Perez iu përgjigj se nuk kishte ndër mend të rikthente një 38-vjeçar. Qëndrimi i tij shkaktoi zemërim në familjen Ronaldo, që iu kundërpërgjigj me anë të së motrës. Pas takimit kundër Almerias, Perez ka lëshuar batutën e radhës. Numri një i Realit është pyetur nga një tifoz në lidhje me Mbappen, teksa përgjigjja e tij ka qenë epike: "Mbappe? Besoj se do të jetë bërë pishman që nuk erdhi".

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Mana Store” SH.P.K. me pronar Genc Rexhepi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811576216 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mana Store” D.O.O. Genc Rexhepi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811576216 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Mana Store” L.L.C. Genc Rexhepi, has come to the decision to quit its business: 811576216 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Miku Lounge” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811548851 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Miku Lounge” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811548851 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Miku Lounge” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811548851 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Emrullahi Behajdin shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

Violetë Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII të SH.M. Mjekësisë “Hysni Zajmi”.

► Fatmir Bislimaj shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

Muhamet Kadrija shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë “Hysni Zajmi”.

► Hadi Krasniq shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Enver Gllgjani nga Gjakova shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M.T “Gani Qafderbasha Prizren ndërtimtari e përgjithshme.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Dion Bakalli shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

► Ferdez Sahiti nga Gjakova shpall të dëftesën e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e sh.m.p “Gjon Nikoll Kazai” drejtimi administrim biznesi.

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Ajkuna Lila shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII diplomën dhe testin e maturëa të Gjimanzit “Hajdar Dushi”.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

